


Lajmet | Operacionet

15/09/2023

# Sarandë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar "One"

Sarandë

Finalizohet operacioni policor i koduar "One", si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me qytetarët.

Fshihte në banesë, një armë zjarri pistoletë dhe fishekë për të, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 18-vjeçari.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë, municioni luftarak, si dhe një sasi e vogël lënde e dyshuar narkotike kokainë.

Si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë dhe të vazhdueshëm me qytetarët, për të përmbushur objektivat e përbashkët, garantimin e rendit dhe sigurisë publike, si dhe goditjen e paligjshmërive, shërbimet e Komisariatit të Policisë Sarandë kanë organizuar operacionin policor të koduar "One", për kapjen e një shtetasi që mbante armë zjarri në banesë.

Gjatë operacionit, u kap në flagrancë dhe u vu në pranga shtetasi E. Sh., 18 vjeç, pasi gjatë kontrollit në banesën e tij, në lagjen nr. 1, Sarandë, Policia gjeti të fshehur një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak, të cilat posedoheshin nga ky shtetas, pa leje, si dhe një sasi të vogël lënde narkotike kokainë.

Arma, fishekët dhe lënda narkotike kokainë u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për veprime të mëtejshme.

## angazhimpërkushtimsakrificë👮🚔

## tëvendosurkundërkrimit✅

## nëçdoskajtëvendit🇦🇱

## nëshërbimtëqytetarëve👮🤝🧑

Lushnjë – Vihet në pranga 1 shtetas, procedohet 1 tjetër

DVP Gjirokastër – Vihet në pranga 1 shtetas, shpallen në kërkim 2 shtetas, procedohen 5 të tjerë

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2023 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.